

GJYKATA E APELIT
PRISHTINA

Numri i lëndës : PAKR 259/14

Data: 22 Maj 2015

Gjykata themelore: Gjilan, PKR 56/13

Originali: **Anglisht**

Gjykata e apelit në Prishtinë në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja e EULEX-it në gjykatën e apelit Hajnalka Veronika Karpati, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtare raportuese, gjyqtareve vendor të gjykatës së apelit Mejreme Memaj dhe Xhevet Abazi si anëtar të trupit gjykues, të asistuar nga zyrtari ligjor i EULEX-it Alan Vasak, duke vepruar në cilësinë e procesmbajtësit.

Në rastin që ka të beje me të pandehurit:

A.K., mashkull, emri i babit S., dhe i nenës e i vajzërisë A.M., ..., shqiptar Kosovar;

I.P., mashkull, emri i babit A., dhe i nenës e i vajzërisë R.U., ..., shqiptar Kosovar;

B.S., mashkull, emri i babit F., dhe i nenës e i vajzërisë F.M., ..., shqiptar Kosovar;

H.M., mashkull, emri i babit H., dhe i nenës e i vajzërisë H.D., ..., shqiptar Kosovar;

Të akuzuar me aktakuze nga zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) PPS91/11 e ushtruar më 23 Prill 2012 me aktin vijues:

Që nga data e pa specifikuar deri me datën 09.09.2011 në bashkëveprim me njeri tjetrin dhe me personin e quajtur D.P., shtetas i Republikës së Serbisë, duke vepruar si një grup i organizuar dhe i strukturuar kane kontrabanduar migrantet – shtetas të Republikës së Kosovës që ishin të interesuar që në mënyre ilegale të dalin jashtë Kosovës; i pandehuri A.K. dhe H.M. i gjenin migrantet, S.X. dhe dy shoke të te pandehurit H.M. X. dhe një shoke tjetër, me pas ata i dërgonin këta migrantet në shtetet të Evropës perëndimore përmes territorit të Republikës së Serbisë përmes të dyshuarit D.P.; më 09.09.2011 i pandehuri I.P. i gjeti tre migrant pas marrëveshjes me A.K.n: S.G., F.S. dhe S.L.; pas pagesës prej se paku 1.600€ për person i morën këta tre migrant në Gjilan tek A.K., i cili, sipas marrëveshjes i ka dërguar te i pandehuri B.S. i cili me pas do ti dërgonte në fshatin Stublina që ti dërgoj të personi nga Serbia i cili me pas do ti dërgonte ata në France;

sidoqoftë, rrugës i pandehuri B.S. dhe tre migrantet S.G., F.S. dhe S.L. janë ndal nga policia dhe janë dërguar në stacion policor.

Ku veprimet të tilla janë klasifikuar si veprat penal vijuese:

Krim i organizuar, në shkelje të nenit 274 (2) të lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penale të Kosovës (KPPK-se),

Kontrabandimi i migranteve, në shkelje të nenit 138 (6) të lidhur me nenin 138 (1) të KPPK-se.

Të gjykuar në instancën e parë nga gjykata themelore e Gjilanit me aktgjykim PKR 56/13 të datës 5 dhjetor 2013 ku janë gjetur:

Të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. janë shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale të tentimit të kontrabandimit të migranteve në pajtim me nenin 170 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe nenit 28 (1) dhe (2) të KPRK-se dhe nenit 31 të KPRK-se – ku – thënë shkurtimisht – duke vepruar në bashkëveprim me njeri tjetrin me qëllim të përfuturit të dobisë materiale për vete duke tentuar që në mënyre ilegale të kontrabadojnë tre shtetas Kosovar jashtë Kosovës që të hyjnë në zonën Shengen;

I pandehuri A.K. është dënuar me dy (2) vjet burgim duke llogaritur kohën e vuajtur në paraburgim dhe gjobën në shumën prej 2000€. Me tej i pandehuri A.K. obligohet që ta paguaj 300€ dhe 5€ që përputhen me përfitimin material të përvetësuar.

I pandehuri I.P. është dënuar me një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim duke llogaritur kohën e vuajtur në paraburgim dhe me gjobe me shumën prej 200€.

I pandehuri B.S. është dënuar me një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim duke llogaritur kohën e vuajtur në paraburgim dhe me gjobe me shumën prej 500€. Burgimet e shqiptuara nuk do të ekzekutohen nëse të pandehurit nuk kryejnë veprat të tjera penale gjate periudhës së verifikimit prej tre (3) vjetësh. Më tej 295€ është konfiskuar përfitimi material nga i pandehuri B.S..

Të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. janë liruar për veprën penale të tentimit të kontrabandimit të migranteve lidhur me personat të tjerë të cekur në dispozitivë të aktakuzës;

Të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. me tej janë liruar për kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar;

Shpenzimet e procedurës penale janë caktuar që të paguhen pjesërisht nga të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. respektivisht në një paushall prej 50€. Shpenzimet të tjera janë caktuar që të mbulohen nga resurset buxhetore.

I pandehuri H.M. është liruar nga të gjitha pikat e aktakuzës.

Pas pranimit të ankesave të ushtruara kundër aktgjykimit të lartcekur nga:

- Avokati mbrojtës Masar Morina në emër të të pandehurit A.K.;
- PSRK-se;
- Avokati mbrojtës Ymer Huruglica në emër të të pandehurit I.P.;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së:

- Avokati mbrojtës Masar Morina në emër të të pandehurit A.K.;
- Avokati mbrojtës Hajredin Leka në emër të të pandehurit H.M.;

Pas shqyrtimit të mocionit të prokurorit shtetëror të apelit

Pas mbajtjes se seancës publike në gjykatën e apelit me 22 Maj 2015;

Pas mbajtjes se këshillim – votimit të datës 22 Maj 2015;

Duke vepruar në pajtim me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-se);

Nxjerr si në vijim

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e avokatit mbrojtës Masar Morina në emër të të pandehurit A.K. kundër aktgjykimit të gjykatës themelore të Gjilan PKR 56/13 i datës 5 Dhjetor 2013 përmes kësaj refuzohet si e pabazuar.**
- II. Ankesa e avokatit mbrojtës Ymer Huruglica në emër të të pandehurit I.P. kundër aktgjykimit të gjykatës themelore të Gjilan PKR 56/13 i datës 5 Dhjetor 2013 përmes kësaj refuzohet si e pabazuar.**

- III. Ankesa e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore të Gjilanit PKR 56/13 të datës 5 Dhjetor 2013, përmes kësaj refuzohet si e pabazuar.**
- IV. Aktgjykimi i gjykatës themelore të Gjilanit PKR 56/13 i datës 5 Dhjetor 2013 nëpërmjet kësaj konfirmohet.**

ARSYETIMI

I. SFONDI PROCEDURAL

Më 23 Prill 2012 PSRK-ja ka ushtruar aktakuzën PPS 91/11 kundër të pandehurve A.K., I.P., B.S. dhe H.M..

Pasi që i pandehuri A.K. ishte në arrati më 23 tetor 2012, rasti i tij është veçuar nga rasti kundër të pandehurve të tjerë. Është lëshuar fletë rreshtimi ndërkombëtar kundër tij.

Më 5 dhjetor 2012 gjykata themelore e Gjilanit e ka konfirmuar aktakuzën e sipër cekur kundër të pandehurve I.P., B.S. dhe H.M.. Gjate seancës së konfirmimit të tre të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm. Shqyrtimi kryesor kundër të tre të pandehurve ka filluar me 6 qershor 2013. Të pandehurit mbeten pranë qëndrimit të tyre lidhur me akuzat dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Më 7 korrik 2013 gjykata themelore në Gjilan ka pranuar informata se i pandehuri A.K. ka shprehur vullnet të dorëzohet ashtu që shqyrtimi kryesor është shtyre deri në njoftim të ardhshëm.

Më 8 korrik 2013 i pandehuri A.K. u paraqit pranë gjykatës themelore. Seanca fillestare në rastin e tij është mbajtur më 17 korrik 2013. Gjate kësaj seance i pandehuri u deklarua fajtor për secilën pike të aktakuzës. Kryetari i trupit gjykues nuk ishte i bindur se janë plotësuar kriteret të parapara në nenin 248 (1) të KPP-së janë. Prandaj është nxjerr aktvendimi mbi mos pranimin e fajësisë dhe kryetari i trupit gjykues ka vazhduar me seancën fillestare sikurse që deklarata mbi pranimin e fajësisë të mos ishte bërë.

Mbrojtja e të pandehurit Afri Kurdiu nuk ka ushtruar kundërshtime kundër provave dhe nuk ka kërkuar hedhjen poshtë të aktakuzës. Me anë të aktvendimit të datës 20 gusht 2013 rasti kundër tij është ribashkuar me rastin e të pandehurve I.P., B.S. dhe H.M.. Prandaj ishte e nevojshme që të fillojmë me shqyrtimin kryesor që nga fillimi me të gjithë të 4 të pandehurit.

Shqyrtimi kryesor kundër të 4 të pandehurve ka filluar me 10 shtator 2013. Të pandehurit H.M. dhe I.P. u deklaruan të pafajshëm, i pandehuri B.S. u deklarua fajtor për piken e kontrabandimit të migranteve dhe A.K. u deklarua fajtor për secilën pike të aktakuzës. Gjykata themelore gjeti se nuk janë plotësuar kriteret nenin 148 (1) të KPP-se, prandaj pranimi i fajësisë i të pandehurit A.K. nuk është pranuar.

Shqyrtimi kryesor ka vazhduar me 21 dhe 22 tetor 2013 dhe me 3 e 4 dhjetor 2013 me shpalljen publike të aktgjykimit më 5 dhjetor 2013.

PSRK-se iu është dërguar aktgjykimi me shkrim me 31 janar 2014.

PSRK-ja ka ushtruar ankesën me 12 shkurt 2014.

Të pandehurit H.M. iu është dërguar aktgjykimi me shkrim me 3 shkurt 2014.

I pandehuri nuk ka ushtruar ndonjë ankese.

Të pandehurit A.K. iu është dërguar aktgjykimi me shkrim me 3 shkurt 2014.

I pandehuri përmes avokatit të tij ka ushtruar ankesën me 11 shkurt 2014.

Të pandehurit B.S.t iu është dërguar aktgjykimi me shkrim me 10 shkurt 2014.

I pandehuri nuk ka ushtruar ndonjë ankese.

Të pandehurit I.P.t iu është dërguar aktgjykimi me shkrim me 12 shkurt 2014.

I pandehuri përmes avokatit të tij ka ushtruar ankesën me 24 shkurt 2014.

Më 19 shkurt 2014 avokati mbrojtës Masar Morina në emër të të pandehurit A.K. ka ushtruar përgjigjen në ankese të PSRK-se.

Më 28 shkurt 2014 avokati mbrojtës Hajredin Leka në emër të të pandehurit H.M. ka ushtruar përgjigjen në ankese të PSRK-se.

Më 13 Maj 2014 rasti është transferuar në gjykatën e apelit për vendimin mbi ankesat.

Më 16 Maj 2014 prokurori shtetëror i apelit ka ushtruar mocionin.

Seanca e trupit gjykues se gjykatës se apelit është mbajtur me 22 maj 2015 në praninë e të pandehurit I.P. dhe avokatit mbrojtës Masar morina në emër të të pandehurit A.K.

Trupi gjykues është këshilluar dhe ka votuar me 22 maj 2015.

II. PARASHITRESAT E PALËVE

A. Ankesa e avokatit mbrojtës Masar Morina

Avokati mbrojtës Masar Morina ka ushtruar ankesën në emër të të pandehurit A.K. mbi bazën e:

- Vendimin mbi sanksionin penal;
- Shkelje të kodit penal;

Dhe propozon gjykatës se apelit që të liroj të pandehurin për veprën penale të tentimit të kontrabandimit të migranteve apo të zvogëloj dënimin e shqiptuar, duke përfshirë gjobën.

Mbrojta paraqet se në pajtim me nenin 107 (1) të KPRK dënimi për veprën penale të kontrabandimit të migranteve është 2 deri në 10 vjet. Prandaj, tentimi i kontrabandimit të migranteve nuk është i ndëshkueshëm, duke parë si në nenin 28 (2) të KPRK-se përshkruan se tentimi për të kryer veprën penale duhet të jete i ndëshkueshëm vetëm nëse dënimi prej 3 apo me shume vite mund të shqiptohet në veprën penale të nënvizuar.

Mbrojta tutje paraqet se në rastin aktual nuk ka migrantet, që shihen se personat të cekur në aktakuzë janë shtetas të Kosovës dhe jo shtetas të ndonjë vendi tjetër. Prandaj veprën penale e kontrabandimit të migranteve mund të këtë mos ndodhur.

Përndryshe mbrojtja pajtohet që për shkak të sjelljes bashkëpunuese të të pandehurit, i pandehuri ka të drejte në reduktim të dënimit të tij deri në 40%

B. Ankesa e avokatit mbrojtës Ymer Huruglica

Avokati mbrojtës Ymer Huruglica ka ushtruar ankesën në emër të të pandehurit I.P. mbi bazën e:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkelje të kodit penal;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike;
- Vendimin mbi sanksionet penale;

Dhe propozon gjykatës se apelit që të nxjerr aktgjykimin lirues, që të miratoj ankesën si të bazuar apo të anuloj aktgjykimin dhe të kthej lenden në rigjykim.

Mbrojtja paraqet se aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e nenit 370 të KPP-se, dhe si rezultat i kësaj ende përmban shkelje esenciale të dispozitave të nenit 384 (1) pika 1.12 të KPP-se, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk paraqet qarte dhe plotësisht faktet që gjykata themelore i ka konsideruar si të provuara. Me tej gjykata themelore nuk ka ofruar ndonjë arsye se në cilat provat dhe faktet e ka bazuar aktgjykimin e ankimuar apo cilat provat kane krijuar bazën për nxjerrjen e dënimit.

Mbrojtja tutje paraqet se faktet e provuara lidhur me të pandehurin nuk përbëjnë veprën penale të tentimit të kontrabandimit të migranteve. Aktet thjeshte janë kryer lidhur me shërbimet e rregullta të taksive pa ndonjë lidhje që ka të beje me veprën penale të mundshme. I pandehuri po ashtu nuk ka përfituar nga ndonjë vepër penale. Gjykata themelore e ka ditur këtë kur e ka përjashtuar rolin e të pandehurit lidhur me vlerësimin e dobive të përfituara. Prandaj, gjykata themelore e kundërshton veten kur e vërteton në dispozitivin se i pandehuri ka kryer veprën penal të tentimit të kontrabandimit të migranteve.

Në vazhdim mbrojtja paraqet se i pandehuri nuk e mohon faktin se ai e ka kontaktuar të pandehurin A.K.; megjithatë kontakti është bere në baze të kërkesë se palëve të dëmtuara. Po ashtu i pandehuri nuk ka dijeni për ndonjë tentim të mundshme të kontrabandimit të migranteve. I pandehuri nuk ka diskutuar këtë me të pandehurin të tjerë e as me palët e dëmtuara; ai thjeshte ishte duke kryer punën e tij si shofer taksie. Mbrojtja me tej paraqet se gjykata themelore ka shkelur ligjin kur e ka shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale të kontrabandimit të migranteve.

Përndryshe, mbrojtja paraqet se duke pasur parasysh faktin se vepra penale ka mbetur si tentim, roli i të pandehurit është i vogël dhe se familja e tij varet nga ai, dënimi i shqiptuar është shume i ashpër dhe do duhej që të shqiptohet dënimi me i bute.

C. Ankesa e PSRK-se

PSRK-ja ka ushtruar ankesën mbi bazat e:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkelje të kodit penal;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike;
- Vendimin mbi sanksionet penale;

Dhe propozon që gjykata e apelit të anuloj aktgjykimin kundërshtues lidhur me lirimin dhe të kthej rastin për rigjykim, gjersa lidhur me dënimin që të modifikoj aktgjykimin kundërshtues lidhur me sanksionet penale duke shqiptuar sanksionet me të ashpër, apo të anuloj aktgjykimin kundërshtues lidhur me këtë pjese dhe të e kthej lenden për rigjykim.

PSRK-ja paraqet se gjetjet e gjykatës themelore, se ekzistojnë prova të pamjaftueshme që të dënohet i pandehuri H.M. për veprat penale, janë të gabueshme, sepse janë disa pjese të provave që të mbështesin dënimin për aktet penale, jo se paku në deklaratën e vet të pandehurit H.M..

PSRK-ja me tutje paraqet se po ashtu ekzistojnë provat të mjaftueshme që të mbështesin dënimin për veprën penal ete krimin të organizuar lidhur me të gjithë të pandehurit, sikurse sipas deklaratës se të pandehurit A.K., se kishte një grup të mire të organizuar në vend.

Në vazhdim gjykata themelore ka dorëzuar shkelje të tjera esenciale të kodit të procedurës penale, duke ofruar arsyet kontradiktore kur nuk ka lejuar zgjerimin e aktakuzës gjate shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit H.M.. Konstatim i bere nga gjykata themelore se prokuroria nuk ka specifikuar veprën penale dhe se dëshmitari që është dashur të thirren, janë të pa bazuara; në të kundërtën kjo është bere në mënyre shume të qarte.

PSRK-ja se fundi ka paraqitur se gjykata themelore nuk e ka vlerësuar saktësisht provat të administruara gjate seancës dëgjimore në veçanti deklaratën e deponuar nga dëshmitaret / migrantet. Kjo ka rezultuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike që e shkelin ligjin, sepse nuk është kontestuese se personat të akuzuar në fakt ka kryer veprën penale që gjenden në aktakuzë. Në vazhdim gjykata themelore nuk ka vërtetuar sasinë e sakte të përfimit material të përvetësuar nga të pandehurit.

D. Përgjigjja e avokatit mbrojtës Masar Morina

Avokati mbrojtës Masar Morina ka ushtruar përgjigjen në emër te të pandehurit A.K. ndaj ankesës se PSRK-se.

Mbrojtja propozon që gjykata e apelit duhet të refuzoj ankesën e PSRK-se si të pabazuar. Mbrojtja paraqet se prokuroria ka dështuar që të përdor mjetin juridik kur gjykata themelore ka konfirmuar aktakuzën. Prandaj, prokuroria është vonuar shume kur e adreson çështjen e refuzimit për ndryshimin e aktakuzës.

Mbrojtja tutje paraqet se dënimi i shqiptuar është larg nga të qenit një dënim i ulte; në të kundërtën është dënimi bukur i larte.

E. Përgjigjja e avokatit mbrojtës Hajredin Leka

Avokati mbrojtës Hajredin leka ka ushtruar përgjigjen në emër te të pandehurit H.M. ndaj ankesës se PSRK-se.

Mbrojtësi i propozon gjykatës se apelit që të refuzoj ankesën e PSRK-se si të pabazuar dhe të konfirmoj aktgjykimin kundërshtues. Mbrojtja paraqet se pretendimet e prokurorisë të paraqitura në ankesën e saj tani më ishin pjese e shqyrtimit dhe rrjedhimisht janë shqyrtuar me kujdes nga

gjykata themelore. Gjykata themelore drejtësisht dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe me të drejte ja aplikuar kodin penal kur ka gjetur se i pandehuri H.M. nuk është fajtor.

F. Mocioni i prokurorisë se apelit

Prokurori i apelit ka ushtruar mocionin duke propozuar gjykatës se apelit që të miratoj ankesën e PSRK-se si mire të bazuar, gjersa lidhur me shfajësimet që të anuloj aktgjykimin ankimues dhe të kthej lenden për rigjykim dhe rishqyrtim në gjykatën themelore, gjersa të modifikoj dënimet për të pandehurit A.K., I.P. dhe A.S. dhe të shqiptoj sanksionet penale me të ashpra kundër të pandehurve apo të anuloj këtë pjese të aktgjykimit dhe të kthej rastin për rigjykim.

Në vazhdim prokurori i apelit propozon që gjykata e apelit të refuzoj ankesat dhe përgjigjet e të pandehurve si të pabazuara.

Prokurori i apelit paraqet se analizat dhe vlerësimet e provave të propozuara nga PSRK-ja janë të pakontestueshme dhe përmbajnë faktet të mjaftueshme fajësuese për të vërtetuar përgjegjësin penale të gjithë të pandehurve për veprat penale me të cilat ngarkohen.

III. GJETJET E PANELIT

A. Kompetenca

Në pajtim me nenin 472 (1) të KPP-se paneli ka shqyrtuar kompetencën e tij dhe pasi që nuk janë ngritur kundërshtimet nga palët paneli do të plotësoj si në vijim. Në pajtim me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi juridiksionin, përzgjedhja e lendeve dhe caktimi i tyre të gjyqtar dhe prokuror të EULEX-it në Kosovë – Ligji 03/L-053 si i modifikuar me Ligjin Nr. 04/L-273 dhe i sqaruar përmes marrëveshjes në mes Shefit të EULEX-it Kosove dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, paneli konstaton se EULEX –i ka juridiksion mbi rastin dhe se trupi gjykues është kompetent që të vendos për rastin konkret në përbërje të dy gjyqtarëve të Kosovës dhe njërit të EULEX-it.

B. Pranueshmëria e ankesave

Të tre ankesat janë ushtruar brenda afatit prej 15 ditëve në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-se. Ankesat me tej janë ushtruar nga personat të autorizuar dhe përmbanin të gjitha informatat të tjera në pajtim me nenin 376 *et seq* KPP-se.

Ankesat janë ushtruar me kohe dhe të pranueshme.

C. Zgjerimi i aktakuzës

Prokurori paraqet se gjykata themelore ka gabuar në ligj kur nuk e ka lejuar kërkesat e saja për zgjerim të aktakuzës lidhur me të pandehurin H.M..

Në pajtim me nenin 351 (1) të KPP-se prokuroria mund të ushtroj akuzën e re kur vepra penale paraprake e kryer nga i pandehur zbulohet gjate zhvillimit të shqyrtimit kryesor. Paneli sidoqoftë, vëren se neni 351 (1) i KPP-se nuk mund të interpretohet ashtu që ti shmanget kërkesave procedurale dhe substanciale ashtu që ti mbroje të drejtat e të pandehurit. Pragu për zgjatjen e aktakuzës në shqyrtimin kryesor po ashtu varet në kërkesat procedurale dhe substanciale të parapara ndër të tjera në nenet 19, 241 dhe 253 të KPP-se. Gjukata themelore në paragrafin 25 të aktgjykimit kundërshtues (sipas numrit të faqeve të versionit të anglishtes), arsyeton se parashtresat për të zgjeruar aktakuzën nuk përmbajnë dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mire të bazuar se i pandehuri H.M. ka kryer veprën penale të ofrimit të ndihmës bashkëkryerësve pas kryerjes se veprës penale. Pas shqyrtimit të procesverbalit të shqyrtimit kryesor të gjykatës themelore të Gjilanit (PKR 56/13) të seancës së mbajtur me 4 dhjetor 2013, faqet 2 dhe 3 (versioni i anglishtes) dhe seancës së mbajtur me 3 dhjetor 2013, faqet 34 dhe 35 (versioni i anglishtes) paneli pajtohet me konstatimin dhe arsyetimin e gjykatës themelore. Provat ekzistuese, domethënë deklaratat e të pandehurit A.K. ishin të mjaftueshme për dyshimin e bazuar.

Paneli e refuzon ankesën si të pabazuar.

D. Vërtetimi jo i plote dhe i gabuar i gjendjes faktike

Ankuesit e ankimuan vërtetimin e gjendjes faktike të bere nga gjykata themelore.

Paneli i ankimues rikujton se kur ligji definton kuptimin “vërtetim i gabuar i gjendjes faktike” dhe “ vërtetim jo i plote i gjendjes faktike”, referohet gabimeve apo lëshimeve që kane të bëjnë me “faktet materiale” që janë kritike për aktgjykimin e arritur¹. Vetëm nëse gjykata themelore ka kryer gabimin fundamentale deri sa ka vlerësuar provat dhe vërtetimin e fakteve a do të përmbys gjykata e apelit aktgjykimin.

Si parim i përgjithshëm vlerësimi i provave duhet të mbështetet në marrjen në pyetje të drejtpërdrejt dhe të menjëhershme të dëshmisë verbale dhe deklaratave nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtar. Leximi i procesverbaleve të provave të ekzaminuara në gjykim, pavarësisht sa të sakte dhe të besueshme mund të jene, gjithmonë është instrument me pak i besueshme për vlerësimin e provave. Edhe ekzaminimi i dokumenteve dhe provave të tjera materiale në përgjithësi janë me të sakta në gjykim sepse shpesh këto pjese të provave duhet të jen në

¹ B. Petric ne: komentet e neneve ne Kodit te Procedurës Penale te Jugosllavisë, botimi I 2 1986, neni 366, paragrafi 3.

përputhje me elemente të tjera dhe të jene pjese e sqarimeve verbale nga dëshmitarët apo palët. Prandaj sikurse që është konfirmuar nga kjo gjykate në rastet të tjera², “është parim i përgjithshëm i procedurës ankimore se gjykata e apelit duhet të jep kufi të respektit në gjetjet e fakteve të arritura nga trupi gjykues sepse është kjo e fundit që është me se mire e caktuar që të vlerësoj provat”. Kjo është në përputhje me standardet të aplikuara nga Gjykata Supreme “të mos pengohet gjetjet e gjykatës përveç nëse provat të gjetura e të mbështetur nga trupi gjykues nuk mund të ishin pranuar nga asnjë gjykate e arsyeshme e fakteve, apo kur vlerësimet e saja janë plotësisht të gabuara³”.

Duke pasur parasysh këtë trupi gjykues apo paneli me kujdes i ka analizuar provat në këtë procedure penale se bashku me arsyetimin e gjykatës themelore në aktgjykimin kundërshtues. Paneli me tej me kujdes i ka shqyrtuar argumentet të ofruara në ankesat, përgjigjet dhe mocione të prokurorit të apelit.

Gjykata themelore në aktgjykimin kundërshtues në detaje ka analizuar provat të administruara gjate gjykimit kryesor. Në pike vështrim të panelit gjykata themelore vjen deri të një konstatim logjik në vlerësimin e saj të asaj prove. Paneli i ka ekzaminuar analizat në detaje të gjetjeve faktike, të cekura në faqet 9 deri në 16 të aktgjykimin kundërshtues (sipas faqeve të renditura të versioni të anglishtes), dhe i ka miratuar këto analizat në tërësinë e saj. Paneli gjene se ekziston provat të mjaftueshme që të dëshmohet se të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. kane kryer veprën penale të tentimit të kontrabandimit të migrantëve në bashkëveprim. Paneli ne vazhdim gjene se nuk ka prova të mjaftueshme që të dëshmohet se të pandehurit A.K., I.P. dhe B.S. kane kryer veprën penale të Krimin të organizuar. Me tej trupi gjykues gjene se nuk ka prova të mjaftueshme që të dëshmohet se i pandehuri H.M. ka kryer ndonjë nga veprat penale që akuzohet.

Paneli me kujdes të veçantë ka shqyrtuar analizat e gjykatës themelore lidhur e rolin e të pandehurit I.P., të adresuar me saktësisht në paragrafin 46 (sipas faqeve të renditura të versioni të anglishtes). Paneli është i bindur plotësisht nga konstatimi dhe arsyetimi i gjykatës themelore dhe nuk gjene të meta apo kundërshtime në qëndrimin e gjykatës themelore. Mbrojtja nuk sjell ndonjë argument të ri që nënvizojnë këtë analize. Prandaj paneli plotësisht pajtohet me arsyetimin e gjykatës themelore se veprimet e kryera nga i pandehuri I.P. – me tepër në veçanti, diskutimet e detajeve të kontrabandimit, sjellja e palëve të dëmtuara në kontakt me të pandehurin A.K. dhe vozitja/ dërgimi i palëve të dëmtuara në Gjilan – përbënë veprën penale të tentimit të kontrabandimit të migrantëve në bashkëveprim. Duke pasur parasysh natyrën e veprimeve të kryera të cekura mësipërm, paneli nuk beson se i pandehuri I.P. nuk ishte në dijeni mbi faktin se ai ishte duke kryer veprën penale të (tentimit) të kontrabandimit të migrantëve.

² PAKR 1121/12, aktgjykimi i datës 25/09/2012.

³ Gjykata Supreme e Kosovës AP – KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35, gjykata supreme e Kosovës AP – KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30

Me tej paneli me kujdes ka shqyrtuar analizat e gjykatës themelore lidhur me akuzat të krimit të organizuar, të adresuara në aktgjykimin kundërshtues në faqet 18 dhe 19 (sipas faqeve të renditura të versioni të anglishtes). Paneli edhe njëherë plotësisht është i bindur nga konstatimi dhe arsyetimi i gjykatës themelore dhe nuk gjene kundërshtime në qëndrimin e gjykatës themelore. Paneli gjene se edhe pse mund të identifikohet një shkalle e strukturës ku të pandehurit kane vepruar, provat sugjerojnë se një strukture e tille ishte jo e rëndësishme, e zakonshme dhe thjeshte në vend për këtë vepër penale të caktuar. Prandaj, paneli plotësisht pajtohet me arsyetimin e gjykatës themelore se provat të paraqitura nga prokuroria nuk dëshmojnë përtej dyshimit të arsyeshme se aktet e kryera nga të pandehurit janë kryer si pjese e një shoqate të strukturuar, e themeluar gjate një periudhe kohore.

Paneli po ashtu ka shqyrtuar me kujdes të veçantë analizat e gjykatës themelore lidhur me shfajësimin e të pandehurit H.M., të adresuar në aktgjykimin kundërshtues në paragrafin 43 (sipas faqeve të renditura të versioni të anglishtes). Paneli edhe njëherë plotësisht është i bindur nga konstatimi dhe arsyetimi i gjykatës themelore dhe nuk gjene kundërshtime në qëndrimin e gjykatës themelore. Paneli gjene se edhe pse ekzistojnë ca tregues se i pandehuri H.M. ishte përfshirë në aktakuze rreth vepre penale të tentimit të kontrabandimit të migranteve, provat të mjaftueshme mungojnë që të dëshmohet përfshirja e tij përtej dyshimit të arsyeshëm. Prandaj, paneli plotësisht pajtohet me arsyetimin e gjykatës themelore.

Lidhur me përfitimin material të përvetësuar nga të pandehurit A.K. dhe B.S., paneli pajtohet me arsyetimin e gjykatës themelore se provat të prezantuara në këtë rast është e mjaftueshme vetëm që të vërtetohet se secila pale e dëmtuar ka paguar 200€ të pandehurit A.K.. Pretendimet se shuma me e madhe është paguar nuk është arsyetuar mjaftueshëm.

Në përkufizim paneli gjene se aktgjykimi nuk përmban një vërtetim jo të plote dhe të gabuar të gjendjes faktike. Më tej gjykata themelore vjen në përfundim logjik në vlerësimin e saj të provave të prezantuara. Prandaj, parashtrësat të mbrojtjes dhe prokurorisë janë refuzuar si të pabazuara.

E. Tentim

Avokati mbrojtës Masar Morina paraqet se një tentim i veprës penale të kontrabandimit të migranteve nuk është i ndëshkueshme, pasi që dënimi për veprën penale është dy (2) vjet deri në dhjete (10) vjet, nga kjo parakushti i nenit 28 (2) të KPRK-se – se tentimi për të kryer veprën penale mund të ndëshkohet vetëm nëse shqiptohet dënimi prej tre (3) apo me shume vitesh, kështu që në veprën penale të nënvizuar – nuk është plotësuar një gjë e tille.

Paneli nuk pajtohet me këtë arsyetim. Neni 28 (2) të KPRK-se ka të beje me dënimin maksimal të përshkruar për veprën penale të nënvizuar dhe jo ndëshkimin minimal. Në pajtim me nenin 170 (1) të KPRK-se ndëshkimi deri në dhjete (10) vjet mund të shqiptohet për kryerjen e veprës

penale të kontrabandimit të migranteve, ashtu që parakushti prej tre (3) apo me shume vite të nenit 28 (2) të KPRK-se qarte është i plotësuar.

Parashtresa e mbrojtjes është refuzuar si e pabazuar.

F. Shtetas të Republikës se Kosovës

Avokati mbrojtës Masar Morina debaton se pasi që palët e dëmtuara janë shtetas të Republikës se Kosovës, aktet e kryera nuk kualifikohen si veprat penale të kontrabandimit të migranteve.

Paneli nuk pajtohet me këtë arsyetim. Neni 170 (8.1) të KPRK-se qarte deklaron se hyrja ilegale e personit i cili është shtetas i Republikës se Kosovës në shtetin ku personi i tille nuk është banor i përhershëm apo shtetas i shtetit të tille (po ashtu) përbënë veprën penale të kontrabandimit të migranteve. Për atë që avokati mbrojtës debaton se i pandehuri nuk ka kontrabanduar palët e dëmtuara jashtë Kosovës, paneli vëren se të pandehurit janë shpall fajtor për një tentim të kontrabandimit të palëve të dëmtuara, ashtu që elementi i kalimit ilegal të kufirit nuk duhet të përmbushet.

Parashtresa e mbrojtjes është refuzuar si e pabazuar.

G. Pa kuptueshmëria apo mos përputhshmëria e dispozitivit

Avokati mbrojtës Ymer Huruglica pretendon se aktgjykimi është i mos përputhshme dhe i dy kuptueshëm për shkak të kundërshtimeve në mes të dispozitivit dhe arsyetimit që kane të bëjnë me qëllimin e të pandehurin I.P. që të përvetësoj dobi materiale nga kontrabandimi i migranteve.

Paneli vëren se në paragrafin 49 në faqen 15 të aktgjykimit kundërshtues (sipas faqeve të renditura të versionit të anglishtes) gjykata themelore ka gjetur se nuk ka provat të mjaftueshme se i pandehuri I.P. ka pranuar nga palët e dëmtuara para të tjera përveç shumes prej 20€ për person të paguara që ti vozis nga Peja për në Gjilan. Sidoqoftë, kjo nuk e kundërshton dispozitivin e aktgjykimit kundërshtues ku i pandehuri I.P. është shpallur fajtor për tentimin të kontrabandimit të migranteve në bashkëveprim me qellim të përfutimit të dobisë materiale. Edhe pse i pandehuri I.P. mund të mos ketë pranuar pagese shtese përtej shumes prej 20€ për person, ai ende e ka pranuar këtë shume të hollave në kuptim të veprës penale, pasi që i ka transportuar palët e dëmtuara G. dhe S. tek i pandehuri A.K. në Gjilan, nga ku palët e dëmtuar do të merrnin transportim të mëtutjeshëm me qellim që të kontrabandohen në zonën Shengen.

Në vazhdim është e qarte nga arsyetimi – dhe provat mbi të cilat gjykata themelore e ka bazuar ndëshkimin – se i pandehuri A.K. ka vepruar me qellim të përfutimit, dhe po ashtu ka pranuar

përfitim material. Duke ditur se i pandehuri I.P. ka vepruar në bashkëveprim me *inter alia* të pandehurin A.K., qëllimi për të përfituar përfitim material nga kontrabandimi i migranteve po ashtu aplikohet në veprimet të kryera nga i pandehuri I.P.. Prandaj, dispozitivi nuk është në kundërshtim me arsyetimin sa i përket qëllimit të të pandehurit I.P. që të përfitoj dobi material nga kontrabandimi i migranteve.

Parashtresa e mbrojtjes është refuzuar si e pabazuar.

H. Vërtetimi i gabuar i dënimit

Të pandehurit A.K. dhe I.P. e kanë ankimuar vërtetimin e ndëshkimit, duke e konsideruar shumë të ashpër.

Në pajtim me nenet 28, 41,74, 75 dhe 76 të KPRK-se gjykata themelore në faqet 20 dhe 22 të aktgjykimit kundërshtues (sipas faqeve të renditura të versionit të anglishtes) ka marrë parasysh të gjitha faktorët relevant të nevojshme që të përcaktojnë një ndëshkim adekuat. Paneli plotësisht pajtohet me këtë analizë. Gjykata themelore në mënyrë të duhur ka vlerësuar dhe peshuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe ka ardhur me dënim proporcional. Të pandehurit A.K. dhe I.P. nuk ka paraqitur ndonjë rrethane të re që tani më nuk është marrë në konsideratë nga gjykata themelore. Prandaj, paneli refuzon parashtresën e mbrojtjes.

I. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e apelit – për arsye të shtjelluara mësipërm – i refuzon ankesat dhe konfirmon aktgjykimin kundërshtues.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim i datës 25 qershor 2015.

Kryetare e trupit gjykues

Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtare e trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Mejreme Memaj
Gjyqtar vendor

Xhevdet Abazi
Gjyqtar vendor

Procesmbajtësi

Alan Vasak
Zyrtari ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit
Prishtina

PAKR 259/14
22 Maj 2015